

Në zbatim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju përcjell informacionin e kërkuar me shkresën nr.3734/1 datë 24.10.2016, si më poshtë vijon:

I. *Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët sipas ligjit kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë:*

Në zbatim të ligjit nr.9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publik” dhe ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, zyrtarët që kanë detyrim për Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor në Universitetin e Tiranës janë:

- Z.Mynyr Koni, në cilësinë e Rektorit të Universitetit të Tiranës, ka përfunduar studimet e larta në degën Biologji-Kimi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së, me titullin akademik “*Profesor*”. Paguhet me pagën e pozicionit “*Rektor*”, sipas lidhjes nr.I të VKM nr.507 datë 01.08.2012, “*Për disa ndryshime në Vendimin nr.748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë*”, të ndryshuar.
- Z.Robert Skënderi, në cilësinë e Kancelarit të Universitetit të Tiranës, ka përfunduar studimet e larta për Ekonomi në Fakultetin e Ekonomisë të UT-së, ka përfunduar studimet master i nivelit të dytë, dhe një sërë kualifikimesh postmaster. Paguhet me kategorinë II-b të lidhjes nr.II të VKM nr.589 datë 17.07.2013 “*Për disa ndryshime në Vendim nr.545 datë 11.08.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunës, zëvendësmintrit dhe nëpunësve të kabinetit, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qëndror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucione në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*”, të ndryshuar.

II. Struktura e pagave për punonjësit e tjerë të Universitetit të Tiranës, nuk ka ndryshime nga viti 2015.

Këto të dhëna janë përditësuar dhe janë pasqyruar në web-in e Universitetit të Tiranës.